

**STATUTI**  
**I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"STUDIT" SH.P.K..**

Sot ,me 08/08/2022 , ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private Siper marrjeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marredheniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723 ,date 03.05.2007 "Per qendren kombetare te regjistrimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e saj te lire ,te nenshkruar ne kete Statut,i cili vlen dhe si Akt Themelimi:

**Arjanita Livadhi** lindur ne Tirane me 14/11/1996 ne Shqiperi, me numer dokumenti J66114034P, e cili ka vendosur te hartohet Statuti dhe Akt Themelimi i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

**Neni 1 – Emertimi**

1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **STUDIT Sh.p.k.** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria")

**Neni 2 – Forma ligjore**

2.1 Shoqeria **STUDIT Sh.p.k.** eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon,dhe ka vlere ne baze te legjislacionit shqiptar dhe si Akt Themelimi

2.2 Shoqeria operon ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

**Neni 3 – Selia**

3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: Tirane,Rruga "Bulevardi Bajram Curri",GALERIA ETC,KATI III-te.

3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.

3.3 Mbledhja e Ortakeve,mund te vendose, transferoje dhe/ose te mbylle, si brenda edhe jashte shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale,seli, agjensi, zyra perfaqesimi dhe bashkesi lokale te cdo natyre.



## Neni 4 – Objekti

Shoqeria ka focus objektivin e saj kryesor ne zhvillimin e Konsulencave profesionale brenda dhe jashte vendit duke asistuar studentet ose individet te cilet duan te studiojne apo punojne jashte vendit.

Ne perputhje me te gjitha normat ligjore administrative Shoqeria do te ofroj sherbim aplikimi per studime, shkollim profesional, Au Pair ose Punesim, krijim cv, letra motivimi dhe njehesim diplome.

Shoqeria mund te kryeje aktivite promovuese, informative permes zbatimit te çdo nisme te aftë për të kontribuar në përhapjen e njohurive. Mesim i gjuhes se huaj online nepermjet portalit Studit Academy ku gjuhet e perfshira do te jene: gjermanisht, anglisht, frengjisht, spanjisht etj.

Punesim freelance i mesuesve te huaj dhe shqiptare me kohe te pjesshme dhe te plote. Projektimin, Menaxhimin, koordinimin e veprimeve promo-marketing.

Nepermjet portalit Studit Wellbeing, shoqeria do te ofroje Konsulencen e mireqenies mendore dhe fizike per individet dhe studentet brenda & jashte vendit.

Organizimi dhe kryerja e veprimtarive kulturore, informuese, konferenca, me menaxhimin e hapësirave të caktuara në ambientet e veta dhe / ose të palëve të treta , promovimin dhe organizimin e evenimenteve.

Shoqeria do të jetë në gjendje të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur dhe plotësues si ato të mësipërme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të saj dhe Per kete qellim mundet, me shembull, por pa u kufizuar, te kryeje:


Krijimin dhe rrjetezimin e nje sistemi qe synon informimin, promovimin dhe me referencë të veçantë në proceset e shkollimit prane Universiteteve te ndryshme ne Gjermani, Hollande, Angli etj ,duke realizuar cdo initiative tjeter qe mund ta garantoje zhvillimin me reference te vecante ne proceset e inovacionit te studimeve;

Te paraqese, promovoje dhe realizoje projekte per zhvillimin dhe perfeksionimin e biznesit, te organiizoje takime dhe seminare, konferenca dhe konventa.

Shoqeria do te ofroj sigurimin e sherbimeve te prenotimeve dhe shitjes dhe me parapagim te biletave per evente online ,evente live si dhe te tjera rikreative dhe argetuese;

Projektimin, Menaxhimin dhe realizimin e faqeve dhe portaleve për promovimin e shërbimeve dhe mundësive të ofruara në fushën e studimeve;

Menaxhimin e hapësirave informative strategjike per studimet dhe mundesite e punesimit duke ofruar shërbime këshilluese operative dhe logjistike;



Realizimi i qëllimit të shoqërisë mund të ndiqet edhe përmes mjeteve të shitjes së disponueshme në treg për pajisjet apo produktet të lidhura kryesisht me fushën e studimeve.

Përveç kësaj, me fondet e saj shoqëria mund të kryejë çdo lloj operacioni me karakter të luajtshëm dhe të paluajtshëm që konsiderohet i dobishëm për të arritur qëllimin e shoqërisë, duke përjashtuar kategorikisht ato operacione të ndaluara nga ligji.

### **Neni 5 – Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

### **Neni 6 – Kapitali**

6.1. Kapitali është 100.000 (njqind mijë) leke i përbërë nga 1 (nje) kuote e barazvlefshme me vlerë nominale përkatësisht 100 000 (njqindmijë) leke të **Arjanita Livadhi -t**

6.2 Kapitali i shoqërisë është plotësisht i regjistruar dhe i leshuar në mënyrën e mëposhtme:

**Arjanita Livadhi** zoteron 100% (njqind për qind) të kapitalit të shoqërisë i barazvlefshëm me 1(nje) kuote.

### **Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave**

7.1 Kuotat sociale janë të transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore të parashikuara në STATUT.

### **Neni 8 – Administratorët**

- 8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të veprojë veçmas ose bashkërisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.
- 8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë tre-vjeçare (3) me mundësinë për t'u rrimëruar.
- 8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.
- 8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.





8.5 Administratorët mund të emërojnë prokure te veçantë për një akt ose një sërë aktesh.

8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas nje tarife te parashikuar ne ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë në lidhje me funksionin e tyre administrativ.

8.7 Me kete akt themelimi vendoset si Administratore i Shoqërisë:

**ARJANITA LIVADHI** lindur ne TIRANE,SHQIPERI me 14/11/1996 bija e Luanit dhe numer dokumenti J66114034P.

### Artikull 9 – Gjuha

9.1 Ky Statut hartohet në tri (3) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe

9.2 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesja e vetme e Shoqërisë **STUDI**

**Sh.p.k** 'e cila nenshkruan me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

\* \* \*

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**ARJANITA LIVADHI**

Arjanita Livadhi

